

URDHËR
Nr. 230, datë 6.6.2012

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË RI TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
"BACHELOR" NË "LOGOPEDI" DHE FILLIMIN E VEPRIMTARISË
AKADEMIKE PËR KËTË PROGRAM PRANË SHKOLLËS SË LARTË
UNIVERSITARE PRIVATE "MEDIKADENT"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 44/1 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 674, datë 27.9.2006 "Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare private "Medikadent"

URDHËROJ:

1. Hapjen pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore të Aplikuara të shkollës së lartë universitare private "Medikadent", Tiranë, të programit të ri të studimit të ciklit të parë në "Logopedi", që realizohet me 180 kredite, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare "Bachelor" në "Logopedi".
 2. Ky program studimi hapet në bazë të vendimit nr. 140, datë 21.1.2011 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.
 3. Shkolla e lartë universitare private "Medikadent", duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtij programi studimi, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.
 4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij urdhri.
 5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe shkolla e lartë universitare private "Medikadent".
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj